



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr.546/20 Prot

Tiranë, më 27.09.2016

V E N D I M

Nr.120, Datë 27.09.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE TIRANË “MBI ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT TATIMOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË
ARDHURAVE TATIMORE, KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE
E SHËNDETËSORE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeadituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Përgjithshëm Sekretari i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” për periudhën nga 01.01.2014 – 31.12.2015

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit u konstatuan se, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438 dt 28.12.1998, sipas nenit 33/1 “Depozitimi i vendimit pas miratimit të rezultatit vjetor dhe destinacionit të fitimit” ku në pikën 1 cilësohet “Shoqëritë tregtare, sipas ligjit”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi” dhe pika 3 ku cilësohet “Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit”, është konstatuar se subjektet kanë kryer pagesën e tatimit mbi dividendin e shpërndarë mbas datës 20 Gusht të vitit 2014 dhe vendimet e asamblesë së ortakëve për këto pagesa, nuk janë dorëzuar në DRT Tiranë, as në QKR.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17-41 të Raportin Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

Nga DRT Tiranë, të merren masa të menjëhershme për të evidentuar subjektet tatimpagues të biznesit të madh që kanë shpërndarë fitimin (dividentin) me vendim të asamblesë së ortakëve pas datës së miratimit të rezultatit financiar, për herë të dytë gjatë vitit 2014 dhe në mungesë të dokumantacionit të protokolluar në DRT Tiranë, duke bërë rillogaritjet e detyrimeve për çdo subjekt që nuk është përfshirë në *Aneksin nr.2.2.1 dhe nr.2.2.2 bashkëngjitur* Raportit Përfundimtar të Auditimit, por ka të njëjtën problematikë.

Afati: Menjëherë

2. Nga auditimi ka rezultuar se DRT Tiranë nuk ka bashkëpunuar me DRT të Qarqeve për subjektet që kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në fushën e lojërave të fatit, me qëllim mbulimin e tyre me kontrole në terren dhe evidentimin e aktivitetit, njoftimin e NJMLF-së, si dhe marrjen e masave në kohë për bllokimin e aktivitetit të paligjshëm të tyre, në kundërshtim me nenin 50 pika 2 të Ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

DRT Tiranë, me marrjen e njoftimeve nga NJMLF, deklaramet për tatimin për lojërat e fatit, për mbylljen e aktivitetit, apo NIPT-ve sekondare nga subjektet e regjistruara në DRT Tiranë, duhet të bashkëpunojnë me NJMLF-në dhe me DRT përkatëse, ku kanë shtrirë veprimtarinë këto subjekte, për ushtrimin e kontroleve ndaj tyre.

Afati: Menjëherë

3. Nga auditimi ka rezultuar për shoqërinë “**■**” me NIPT **■**, referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se ka diferenca midis të ardhurave nga shitjet sipas TVSH-së dhe shifrës së afarizmit të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2014, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me manualin e vlerësimit.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

DRT Tiranë për shoqërinë “**■**” me NIPT **■**, të bëjë rakordimin e të ardhurave sipas deklarimeve për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe të ardhurave sipas shifrës së afarizmit sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2014.

Afati: Menjëherë

4. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional u konstatuan se në dosjet e kontrollit mungonte një analizë e detajuar e shpenzimeve të paraqitura në PASH, ku si objekt i kontrollit është tatim fitimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me manualin e kontrollit tatimor.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 41-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

Në çdo raport kontrolli të bëhet një analizë më e hollësishme e shpenzimeve të subjektit duke i ndarë shpenzimet me faturë dhe shpenzimet e pa deklaruar në FDP, për të rakorduar blerje të deklaruar në FDP me shpenzimet në bilanc.

Afati: në Vazhdimësi

5. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional, u konstatua se në raportet e kontrollit të subjekteve në analizën e importeve mungojnë të dhëna për referencat doganore për të mundësuar një analizë të shpenzimeve të deklaruar në FDP me shpenzimet në bilanc.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 41-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

Të pasqyrohet dhe të analizohet, në raportin e kontrollit të subjektit analiza e detajuar e TVSH-së së importeve duke pasqyruar veçmas TVSH-në për faturën e origjinës dhe referencën në doganë, për të mundësuar një kontroll sa më real të situatës financiare të subjekteve objekt kontrolli.

Afati: Në vazhdimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet e prokurimit dhe paralele, **i rekomandoj** Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë në shqyrtim, të kryej evidentimin dhe kontabilizimin, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **464,474,184 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për 36 raste (*subjekte*) të merren masa të menjëhershme ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, për detyrimet dhe penaltetet përkatëse të evidentuara nga shqyrtimi i raportit të kontrollit tatimor për periudhën 2014-2015. Në përfundim të nxirret njoftim vlerësimi përkatës për vjeljen e detyrimeve të lindura në shumën **109,145,699 lekë**, ku është vepruar në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar.
(*Trajtuar në faqet 41-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 3.1 bashkëngjitur*).

Afati: Deri 31.03.2017

2. Për 312 subjekte, në vlerën 16,810,266 lekë, për penaltete të pa vendosur subjekteve tatimpagues të cilët kanë marrë objekte me qira dhe nuk e kanë paguar tatimin në burim brenda afatit ligjor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33/1/a, nenit 35/b, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar Neni 117.
kjo për sa kohë që nuk dokumentohet momenti i pagesës së qerasë në dosjet e inspektorëve.
(*Trajtuar në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.1 bashkëngjitur*).

Afati: Deri 31.03.2017

3. Për 64 subjekte, në vlerën 98,084,703 lekë, për penaltet të pa vendosur subjekteve të cilët kanë vendosur të shpërndajnë dividend pas miratimit të rezultatit financiar në periudhën raportuese të vitit 2014 (për herë të dytë), në kundërshtim me kërkesat e nenit 33/1, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 117.
(*Trajtuar në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.2 bashkëngjitur*).

Afati: Deri 31.03.2017

4. Për 3 subjekte, në vlerën 20,950,000 lekë, për mos përlogaritje të tatimit mbi dividendin e shpërndarë në formë paradhënie pa u mbyllur viti financiar 2014, në kundërshtim me kërkesat e nenit 9, pika 2, nenit 33/1, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 117.
(*Trajtuar në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.3 bashkëngjitur*).

Afati: Deri 31.03.2017

5. Për 12 raste (*subjekte*) në vlerën 9,859,797 lekë, për mos vendosjen e penalteteve, nga mos rakordimi i të dhënave me NJMLF-në sipas nenin 50 pika 2 të Ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, kanë rezultuar se ka detyrime të papaguara, kamatëvonesa dhe gjoba,për tatimin mbi lojërat e fatit.
(*Trajtuar në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Afati: Deri 31.03.2017

6. Për 3550 raste të mosvendosjes së penaliteteve në vlerën 177,500,000 lekë, sipas aneksit nr. 2.1.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, neni 126 "Mosdhënia e informacionit".
(Trajtuar në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Afati: Deri 31.03.2017

7. Për 11 raste të mos vendosjes së penaliteteve në vlerën 28,543,719 lekë, sipas aneksit nr. 2.1.2 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 68 pika 4.
(Trajtuar në faqen 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Afati: Deri 31.03.2017

8. Për mosvendosjen e penaliteteve në vlerën 3,580,000 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, neni 122 pika 1, germa a, b.
(Trajtuar në faqen 42-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Afati: Deri 31.03.2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (ç) "largim nga shërbimi civil", për nëpunësit civil si më poshtë:

1. **Z. Gj. D.**, me detyrë ish Përgjegjës i sektorit të kontrollit dhe aktualisht Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
2. **Znj. D. V.**, me detyrë Inspektore në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
3. **Znj. A. T.**, me detyrë Inspektore në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, ligjit nr. 8438 "Për tatimin mbi të ardhurat", datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për TVSH-në" me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit.
(Trajtuar në faqet 41-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Neni 58, germa (c) "pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", për nëpunësit civilë si më poshtë:

4. **Z. P. M.**, ish-Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse.

5. **Znj. E. N.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
6. **Znj. I. V.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
7. **Z. L. Nj.**, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
8. **Znj. L. Zh.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
9. **Znj. A. N.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
10. **Znj. D. K.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
11. **Znj. M. L.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
12. **Znj. N. S.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
13. **Znj. V. P.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
14. **Znj. I. L.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
15. **Znj. A. F.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
16. **Z. A. M.**, me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

(Trajtuar në faqet 17-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17. **Z. A. C.**, Përgjegjës në Drejtorinë e Kontrollit, aktualisht Drejtor i komanduar në DRT Korçë
18. **Z. A. R.**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit.

(Trajtuar në faqet 41-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19. **Z. O. P.**, Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren
20. **Z. Gj. K.**, Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren
21. **Z. A. D.**, Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit në Terren.

(Trajtuar në faqet 41-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Shënim:

1. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit ish-punonjësit z. I. V. z. S. S., z. R. P., z. E. S., znj. R. Ll. z. E. K., z. F. K., janë në nivelin e masës, sipas nenit 58, germa (ç) “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civil, por nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi tatimor.

2. Për ish- punonjësit z. F. C., znj. Xh. L., znj. J. T., z. G. Th., z. G. K. z. L. S., z. B. B. z. A. S., z. E. C., z. Sh. A., znj. A. K. z. E. K., znj. K. P., znj. M. G., z. N. C., z. V. L., znj. Y. P., z. R. B., z. I. A., z. B. M., janë në nivelin e masës, sipas neni 58, germa (c), “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dyvjet”, por nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi tatimor.

3. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësi, E. K., z. L. L., z. N. Q., z. D. M., B. Xh., z. A. K., z. P. O., z. E. C., z. D. Gj., znj. M. K., z. B. N është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore.

D. TË TJERA

PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Nga auditimi në disa drejtori rajonale tatimore është konstatuar problematika e miratimit të shpërndarjes së dividendit pas miratimit të rezultatit financiar, bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, nenit 33/1 “Depozitimi i vendimit pas miratimit të rezultatit vjetor dhe destinacionit të fitimit” ku cilësohet në pikën 1, “Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë në fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që dotë përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi”. Në pikën 3 kërkohet që “Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit”.

Dividenti është shpërndarja e fitimit pas tatimit për pronarët pas miratimit të rezultatit financiar. Pra dividendi është i lidhur me fitimin dhe po ti referohemi nenit 19 të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” “Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim. Në këtë kontekst dividendi nuk mund të shpërndahet nga momenti i miratimit të rezultatit financiar.

Nga ana tjetër sjellim në vëmendje se dividendi rrjedh nga fitimi i tatueshëm dhe trajtimi i tij vetëm fiskalisht, shpërndahet nga konteksti kontabël ndërkohë që në vetë kërkesën ligjore orientohet nga kërkesat e ligjit për “Për kontabilitetin”, ka lënë hapësira për interpretime subjektive nga ana e administratës tatimore.

Shpjegojmë se po ti referohemi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit respektivisht SKK nr.1 – Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, në pjesën e trajtimit të ngjarjeve pas përfundimit të periudhës raportuese cilësojmë rastin:

Deklarimi i dividendëve pas përfundimit të periudhës raportuese.

Nëse një njësi ekonomike u deklaron dividendët mbajtësve të instrumenteve të kapitalit neto të saj, pas përfundimit të periudhës raportuese, njësia ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si një detyrim në fund të periudhës raportuese. Shuma e dividendit mund të paraqitet si një komponent i ndarë nga fitimet e pashpërndara në fund të periudhës raportuese.

Në këto kushte rekomandoj që nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pas analizës së rasteve të konstatuara nga KLSH në drejtoritë rajonale tatimore dhe në zbërthim të trajtimit kontabël të dividendit të hartojë një udhëzues teknik, orientues për të gjithë punonjësit e administratës tatimore por edhe për të sensibilizuar taksapaguesit për të ardhmen.

Afati:Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R